



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË
KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2019**

Prishtinë, gusht 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Prizrenit, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Ariana Berisha-Rexhëbeqaj Udhëheqëse e Ekipit, Hysen Boqolli dhe Arian Zenelaj Anëtarë, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Luljeta Morina.


TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	5
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	8
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	32
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja	42
Shtojca II: Letër konfirmimi.....	45

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Prizrenit për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Pasqyrat Financiare Vjetore ishin përparuar sipas kërkesave të kornizës për raportim financiar përderisa kishte keq klasifikim të shpenzimeve, të cilat kanë ndikuar në theksimin e çështjes.

Në vitin 2019 Komuna kishte realizuar 84% të buxhetit final. Në kontekstin e sistemit financiar, kontrollet janë të vendosura, megjithatë, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve dhe të hyrave kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Dobësi janë identifikuar në menaxhimin e të hyrave, menaxhimin e personelit, të shpenzimeve, menaxhimin e pasurive, rritje të vazhdueshme të llogarive të arkëtueshmeve dhe detyrimeve. Edhe niveli i lartë i pagesave të thesarit përmes vendimeve gjyqësore/përmbarimore ka ndikuar në rritjen e shpenzimeve shtesë për këto pagesa.

Komuna edhe pse kishte ndjekur një proces formal për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve dhe kishte ndërmarr disa veprime për zbatimin e tyre, mangësitë e njëjta janë duke u përsëritur në disa fusha. Më gjerësisht shih kapitullin 3 dhe tabelën 4 të këtij raporti.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna. ZKA vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës gjatë procesit të auditimit.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Komunës së Prizrenit, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve të Komunës së Prizrenit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-se dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Komuna. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Theksimi i çështjes

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se Komuna gjatë vitit 2019 kishte kryer pagesa dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 881,753€ nga kategoritë ekonomike joadekuate. Nga kjo vlerë, 444,740€ ishin si rezultat i planifikimit buxhetor jo adekuat, ndërsa 437,013€ ishin pagesa të kryera nga thesari në bazë të vendimeve gjyqësore.

Më gjerësisht shih te nënkapitulli 2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këto çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Kryetari i Komunës së Prizrenit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime)dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpалosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në vitin 2019 Komuna kishte realizuar 84% të buxhetit final. Në kontekstin e sistemit financiar, kontrollet janë të vendosura, megjithatë, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve dhe të hyrave kërkojnë përmirësim të mëtejshëm.

Dobësit janë duke filluar nga keqklasifikimi i shpenzimeve, menaxhimi i të hyrave, menaxhimi i personelit, i shpenzimeve, menaxhimi i pasurive, rritje e vazhdueshme e llogarive të arkëtueshmeve dhe detyrimeve. Edhe niveli i lartë i pagesave të thesarit përmes vendimeve gjyqësore/përmbartimore ka ndikuar në rritjen e shpenzimeve shtesë për këto pagesa.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2019 Realizimi	2019 Realizimi %	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	47,594,260	50,880,667	42,816,371	84%	41,749,765	36,765,293
Granti i Qeverisë - Buxheti	38,401,867	38,401,867	34,815,743	91%	33,736,653	30,869,927
Të bartura nga viti paraprak ³ -	0	2,732,486	2,389,112	87%	2,996,203	1,573,645
Të hyrat vetjake ⁴	8,717,394	8,717,394	5,203,034	60%	4,687,469	4,125,517
Donacionet e brendshme	0	490,347	121,279	25%	56,121	83,697
Donacionet e jashtme	0	438,473	221,038	50%	117,311	14,150
Huamarrja	474,999	100,100	66,165	66%	156,008	98,357

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 3,286,407€. Kjo rritje është rezultat i bartjes së të hyrave nga viti paraprak 2,732,486€ si dhe bartjes së donacioneve të brendshme dhe të jashtme në vlerë prej 928,820€ nga viti 2018. Ndërsa, sa u përket Financimeve nga huamarrja për vitin 2019 me Qarkore Buxhetore komuna nga Ministria e Financave (MF) është njoftuar se për vitin 2019 do të ketë shumën prej 474,999€, ndërsa deri në fund të vitit 2019 janë alokuar vetëm vlera prej 100,100€, kjo si rezultat vendimeve nga MF në bashkëpunim me Ministrin e Arsimit dhe të Shëndetësisë. Nga Drejtoria e Arsimit janë buxhetuar për vitin 2019 në vlerë prej 48,325€, ndërsa deri në fund të vitit janë alokuar vlera prej 100,100€. Nga Drejtoria e Shëndetësisë janë buxhetuar për vitin 2019 në vlerë prej 426,674€, ndërsa deri në fund të vitit nuk është alokuar asnjë cent.

Në vitin 2019, Komuna ka shpenzuar 84% të buxhetit final dhe se, krahasuar me vitin e kaluar kemi një rënie të realizimit të buxhetit për 2%.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	2019 Realizimi %	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	47,594,260	50,880,667	42,816,371	84%	41,749,765	36,765,293
Pagat dhe Mëditjet	20,415,529	20,611,778	19,985,963	97%	19,495,068	18,777,598
Mallrat dhe Shërbimet	6,723,217	6,567,707	5,678,409	86%	5,609,365	2,670,957
Shërbimet komunale	1,091,199	1,136,472	808,493	71%	763,464	869,094
Subvencionet dhe Transferet	600,000	702,700	701,262	100%	539,906	463,438
Investimet Kapitale	18,764,315	21,862,010	15,642,244	72%	15,341,962	13,984,206

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

Buxheti fillestar me buxhetin final te kategoritë paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime si dhe subvencione dhe transfere nuk kishte ndonjë ndryshim të madh. Për këto kategori komuna kishte arritur të realizoj në një vlerë të konsiderueshme buxhetin në dispozicion. Përderisa buxheti final për shërbimet komunale përkundër rritjes për 45,228€ për shkak të planifikimit jo të mirë realizimi ishte vetëm 71% e buxhetit final.

Edhe buxheti final në kategorinë e investimeve kapitale ishte rritur për 3,097,695€, dhe se përkundër kësaj rritje realizimi i tij ishte vetëm 72%. Pjesa më e madhe e buxhetit të kësaj kategorie ishte shpenzuar në fund vit dhe kjo kishte ndodhur si rezultat i vonesave në inicimin e procedurave të prokurimit si dhe në nënshkrimin e kontratave si dhe procedurat e zgjatura të ankesave në OSHP.

Çështja B1 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike” shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Siç kemi paraqitur te theksimi i çështjes, Komuna gjatë vitit 2019 kishte kryer pagesa dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 881,753€ nga kategoritë ekonomike joadekuate, si në vijim:

- Si rezultat i planifikimit jo të duhur të buxhetit komuna kishte paguar 444,740€ nga kategoritë ekonomike jo adekuate. Komuna nga kategoria e investimeve kapitale kishte paguar 113,547€⁵, për shpenzime të cilat i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve si dhe 331,193€⁶ për shpenzime të cilat i takojnë kategorisë subvencione dhe transfere.

Shkaku i një keq-klasifikimi të tillë ishte sepse këto shpenzime ishin planifikuar dhe buxhetor gabimisht si projekte kapitale.

- Pagesat e kryera nga thesari në bazë të vendimeve gjyqësore ishin në vlerë prej 437,013€⁷. Këto pagesa ishin për pagat jubilarë dhe pensionale, si dhe për shujta. Prej tyre nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve ishin paguar 346,533€ ndërsa nga kategoria investime kapitaleve 90,480€. Këto pagesa janë kryer nga Thesari dhe në shumicën e rasteve vetëm e njofton komunën për konfirmim të obligimit. Komuna këto pagesa i kishte shpalosur në Pasqyra Vjetore Financiar.

⁵ Tetë raste - Pagesa për mirëmbajtje të rrugëve kryesisht ishin për fshirje, larje, pastrimin e dëborës, pagesa për trajtim të qenve, studim të fizibilitetit, lekturim, shtypje të materialit, harta turistike etj. Këto shpenzim ishin buxhetuar sipas projekteve në tab. 4.2 sipas Ligjit të buxhetit 2019.

⁶ Shtatë raste - Pagesa për klube sportive, teatrove, far gruri etj. Për sport shpenzimet kryesisht janë realizuar për pagat e stafit, trajnerëve, lojtareve, gjyqtareve, komunalit, premia, shpërblimet, pajisjet për punë etj. Shpenzimet janë planifikuar sipas projektit nr 46758 -Projekti politikat zhvillimore te kulturës rinise dhe sportit. Nga projekti 46629 është paguar Furnizimi me farë.

⁷ Të dhënat janë siguruar nga komuna për pagesat me vendime gjyqësore. E njëjta situatë ka rezultuar edhe nga testimi i pesë mostrave që janë audituar për kategorinë mallra dhe shërbime, investime kapitale.

Ndikimi Pagesat e realizuara nga kategoria jo-adekuate, rezultojnë me prezantimin e gabuara të shpenzimeve në Pasqyrat Financiare. Raportimi jo i drejtë i të dhënave për klasifikimin e shpenzimeve, çorienton shfrytëzuesit e këtyre informatave të prezantuar gabimisht në PFV apo ndikon vendimmarrjen e menaxhmentit.

Rekomandimi B1 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që kërkesat të planifikohen dhe kategorizohen sipas ndarjes adekuate të buxhetit. Nëse projeksionet e buxhetuara me ligj të buxhetit nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e komunës, duhet të bëhet ridestini i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve. Kjo duhet të reflektoj në përpjekjen për buxhetimin e kërkesave në kategoritë përkatëse ekonomike dhe fuqizimin e kontrollit për pagesën, evidentimin dhe prezantimin e drejtë të shpenzimeve publike në PFV.

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Prizrenit në 2019 ishin në vlerë 6,952,678€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, të hyrat nga grumbullimi i mbeturinave, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, etj.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Pranimet	% e pranimeve 2019	2018 Pranimet	2017 Pranimet
Të hyrat	8,717,394	8,717,394	6,952,678	80%	6,307,458	6,617,699
Totali	8,717,394	8,717,394	6,952,678	80%	6,307,458	6,617,699

Të hyrat e realizuara janë 80% sepse në planifikim janë përfshirë edhe të hyra nga dënimet e policisë, gjobat e gjykatave dhe agjencisë të pyjeve, kurse te pranimet nuk është paraqitura ky realizim në vlerë 1,032,301€⁸, (ku realizimi do të ishte 92%).

⁸ Dënimet e policisë 970,122€, Gjobat e gjykatave 45,455 edhe Agjencia e pyjeve 16,724€.

Çështja B2 - Shfrytëzimi i parregulltë i pronave komunale

Gjetja

Ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale 06/L-092”, neni 23 pika 1 cek: “Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës”.

Komuna me dt.01.08.2001 ka bërë Marrëveshje mbi Koncesionin për tregjet “B. Curri” dhe “Qylhani” me kohëzgjatje për 10 vite, deri më dt. 01.08.2011, nga kjo datë kanë bërë Aneks kontratë për një periudhë dy vjeçare deri më 01.08.2013, duke u bazuar mbi kushtet e marrëveshjeve fillestare dhe duke cekur se kjo kontratë nuk mund të vazhdohet më tutje.

Që nga viti 2013 tregjet janë shfrytëzuar pa kontrata dhe komuna nuk ka ndërmarr asnjë hap për lirimin e këtyre dy pronave (tregjeve). Mirëpo nga Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave është vendosur të ngarkohet me tarifë deri në vitin 2016. Komuna nga viti 2017 nuk i ka faturuar këta dy shfrytëzues të pronave⁹, pasi që nuk ka bazë ligjore për ngarkesë, përderisa shfrytëzuesit privat brenda këtyre tregjeve, paguajnë qira për shfrytëzimin e tezgave apo lokaleve që gjinden në treg.

Po ashtu, nga viti 2016 tetë parti politike shfrytëzojnë pronat-lokalet komunale me çmim prej 1€ në muaj për lokal, prej tyre tri parti vazhdojnë t’i shfrytëzojnë objektet me kontrata të skaduar. Këto lokale ishin dhënë duke u bazuar në vendimin e asamblesë komunale të dt.29.12.2005.

Sipas zyrtarëve komunal “Procedimi i dhënies në shfrytëzim për hapësirat në fjalë do të bëhet pas hyrjes në fuqi të Udhëzimeve Administrative apo Akteve të tjera nënligjore të cilat janë të domosdoshme për zhvillimin e procedurave. Ministria përkatëse ende nuk i ka publikuar Aktet në fjalë, gjë e cila po vështirëson administrimin e pronës komunale”.

Ndikimi

Shfrytëzimi i tregjeve dhe pronave tjera publike, pa kontrata valide mes komunës dhe shfrytëzuesve të pronës komunale, i shkakton komunës humbje të konsiderueshme financiare.

Rekomandimi B2

Kryetari i Komunës të siguroj marrjen e masave për largimin e shfrytëzuesve ilegal nga pronat publike, arkëtimin e borxheve dhe më pastaj dhënia e pronës publike me qira të realizohet sipas Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale 06/L-092.

⁹ Tregu Qylhani dhe tregu Fatoni “Bajram Curri” kanë pasur kontratën mujore 3,500€, (ku për vit i bie 42,000€ e për tri vite 126,000€), mirëpo në këtë rast komuna nuk e ka trajtuar si borxh sepse pronat janë duke u shfrytëzuar pa kontratë.

Çështja A1 – Mangësi në inkasimin e të hyrave për Leje Mjedisore Komunale

Gjetja

Bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH Nr.01/2017-“Për dhënien e Lejes Mjedisore Komunale” (LMK) neni 15 pika 1.1 dhe 1.2 përcakton se për tu pajisur me LMK aplikuesi duhet të paguaj tarifën në vlerë prej 50€ për vlerën investive të projektit deri 25,000€ dhe tarifën prej 0.2% të vlerës investive të projektit për projektet mbi 25,000€.

Në 28¹⁰ raste komuna ka anashkaluar kërkesat e këtij Udhëzimi¹¹ dhe ka aplikuar nenin 4.3 dhe pika 1.3.1 të “Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale”, nr.01/011-54352 të dt.31.03.2016, për dhënien LMK të cilat parashohin tarifa më të ulëta për të njëjtin qëllim.

Nga aplikimi i kësaj rregulloreje, komuna ka rezultuar me 39,661€ më pak të hyra të arkëtuar nga LMK (komuna ka realizuar të hyra vetëm 3,200€ në vend të 42,861€). Vlen të theksohet se komuna edhe pse kishte hartuar rregulloren e re me 28.03.2019 duke e përshtatur me Udhëzimin Administrativ të MMPH, tek në fund të vitit ka aplikuar tarifatat e rregullta sipas kërkesave ligjore.

Adaptimi dhe miratimi i rregullores së brendshme me mbi 2.5 vite vonesë ka ndodhë për shkak të mos angazhimit të zyrtarëve kompetent komunal (pran DSHP) për të propozuar përditësimin e rregullores komunale respektivisht ndryshimin e tarifës në kohën e duhur.

Ndikimi

Mangësitë e identifikuar kanë rezultuar me inkasim më të ulët të të hyrave nga lejet mjedisore. Kjo reflekton në realizimin e më pak projekteve në dobi të qytetarëve apo mos përmbushjen e plotë të nevojave komunale, për shkak të mos përfshirjes së këtyre fondeve në projeksionet fillestare buxhetore.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të vendos kontrolle duke caktuar zyrtar përgjegjës që përcjelljen ndryshimin/plotësimin e rregullave/ligjeve të nivelit qendror, dhe që të njëjtat përditësime të cilat kanë ndikim në rregulloret e brendshme komunale, duhet me kohë të iniciohen për ndryshim duke i përcjellur për miratim tek organet relevante dhe monitorohet zbatueshmëria e tyre.

¹⁰ Në 25 raste kanë paguar më pak për 39,771€, kurse në tri raste kanë paguar më shumë për 110€.

¹¹ Ky udhëzim ka hyrë në fuqi me 09.05.2017.

Çështja A2 - Mungesa e dokumentacionit për lëshimin e lejes ndërtimore**Gjetja**

Nenet 11 dhe 13 të Ligjit Nr.04/L-012 Për Mbrojtje nga Zjarri, përcaktojnë që: “Organi kompetent për dhënien e lejes për ndërtim, rekonstruim mund të jep lejen për ndërtim vetëm atëherë kur të sigurojë se projekti kryesor për ndërtim në bazë të cilit jepet leja e ndërtimit, ka paraparë përmbushjen e kushteve të posaçme të ndërtimit, me qëllim të mbrojtjes nga zjarri” dhe në Udhëzimin Administrativ MMPH Nr.01/2017-“Për dhënien e Lejes Mjedisore Komunale” neni 6.2 përcakton që “Leja Mjedisore Komunale (LMK) është kusht për marrjen e lejes ndërtimore dhe zhvillimin e veprimtarisë përkatëse”.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, ka kërkuar që para aplikimit për leje të ndërtimit përveç tjera duhet të ofrohen edhe këto dy dokumente si, (Aktvendimi nga Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë dhe Leja Mjedisore Komunale). Në një rast, aplikuesi ka ofruar këto dy dokumente, mirëpo pëlqimi nga Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë ishte i dt.09.09.2016 dhe Leja Mjedisore Komunale ishte i dt.20.09.2016 të cilat ishin marr për ndërtimin e një objekti tjetër.

Komuna me dt. 11.04.2019 ka lëshuar Lejen Ndërtimore¹² duke anashkaluar këto dy kërkesa ligjore. Pas identifikimit të këtij rasti nga ZKA, komuna ka kërkuar të plotësoj këto dy dokumente nga aplikuesi, i cili i ka ofruar me dt. 01.11.2019 duke pranuar me vonesë të hyrën në vlerë 8,938€. Sipas zyrtarit kompetent ishte bërë një lëshim. Vendimi për Leje Ndërtimore ishte bazuar në shqyrtimin e provave tjera duke mos marrë parasysh kërkesat ligjore për lëshimin e saj. Kjo reflekton kompetencën e ulët të stafit dhe kontrollet jo funksionale.

Ndikimi

Mangësitë e identifikuar rrisin rrezikun që ndërtimet të mos përfshijnë masat parandaluese për mbrojtjen ndaj zjarrit apo të ambientit që ka të bëjë me sigurinë e shfrytëzuesve të këtyre objekteve. Gjithashtu kjo do të kishte ndikuar edhe në mbledhjen më të ulët të të hyrave që reflekton me më pak fonde për të realizuar objektivat komunale apo përmbushur nevojat e qytetarëve.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të shtoj kontrollet në mënyrë që të gjitha Lejet Ndërtimore lëshohen sipas kërkesave ligjore dhe të hyrat inkasohen në kohën e duhur.

¹² Leja Ndërtimore nr: 04-351/02-48025 në vlerë 122,990€, dt. 11.04.2019.

Çështja C1 - Mangësi në llogaritjen e bazës së tatimit në pronë**Gjetja**

Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 11 pika 1 definoi: "Zbritja për vendbanimin parësor- Personi fizik, i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit, para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit, i lejohet zbritja prej pesëmbëdhjetë mijë (15,000€) nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit.

Më 14.04.2019 Ministria e Financave përkatësisht Departamenti i Tatimit në Pronë ka njoftuar komunat për vendimin e marr për regjistrimin e numrit personal në rastin e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-005, kjo me qëllim të shmangies së duplikimeve/apo parregullësive dhe sigurimin e zbatimit efektiv të këtij neni. Për më tepër, regjistrimi i numrave personal rrit efikasitetin, garanton informata më të sakta dhe të besueshme në regjistrin e tatimit në pronë dhe sjell përfitime të tjera të shumta për tatimpaguesit.

Në dy nga gjashtë mostrat e testuar ishte aplikuar zbritja për pronat që nuk kishin të evidentuar numrin personal. Ndërsa nga analiza e data bazës për tatimin në pronë të siguruar nga komuna, kemi vërejtur se 5,148 personave iu ishte bërë zbritja pa numër personal.

Pas trajtimit të kësaj çështje nga ZKA, zyrtarët komunal janë drejtuar DTP në MF dhe kanë marrë këtë përgjigje: "Ky problem do të vazhdojë të ekzistojë deri sa të plotësohet numri personal për të gjithë tatimpaguesit" dhe tek në vitin 2021 zbritja nuk do të aplikohet për këto raste. Në vitet në vijim tatimpaguesit do të obligohen që të lajmërohen në Zyrën e Tatimit në Pronë për të zbatuar zbritjen në rastet e parashikuar me ligj, me qëllim që të plotësohet data baza e tatimit në pronë me numrat personal para se të aplikohet zbritja për banim primar.

Ndikimi

Vlersimi i njësive rezidenciale me zbritje pa numër personal, mund të rezultoj me kalkulimin e pa rregullt të zbritjes apo edhe shmangie të tatimit në pronë, ku për pasojë komuna pranon më pak të hyra nga kjo kategori.

Rekomandimi C1

Kryetari i Komunës duhet të siguroj bashkëpunim dhe komunikimi më të mirë në mes të Departamentit të Tatimit në Pronë Komunal dhe Ministrisë së Financave, në mënyrë që të eliminohen gabimet e mundshme në bazën për tatimin e vlerësuar, apo ndonjë gabimi tjetër eventual.

Çështja B3 - Parregullsi në arkëtimin e të hyrave nga sektori i mbeturinave**Gjetja**

Sipas Rregullores “Mbi Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Prizrenit”, neni 3 - Përgjegjësia e Komunës mbi Menaxhimin e Mbeturinave: pika 3.1. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm mbi menaxhimin e mbeturinave të ngurta komunale, dhe neni 5 pika 5.1- Taksa mbi mbeturinat, nga janari i vitit 2014, do të faturohet dhe inkasohet nga Komuna. Ndërsa në shtojcën 1, të kësaj rregullore përcaktohet tarifa e taksës për mbeturina ku për amvisëritë në zonën urbane dhe rurale është 4.50€ për muaj ose 54€ për vit.

Komuna për ngarkesat me tarifën e mbeturinave përdorur të dhënat e data bazës së pro-tax. Rifreskimi i të dhënave në sistemin për ngarkesën e mbeturinave është bërë edhe në baza ditore duke u bazuar në kërkesat dhe ankesat e qytetarëve, ndonjë rifreskim më detal nuk është bërë. Në sistemin e menaxhimit të mbeturinave janë të evidentuar 3,868 amvisëri për qytetarët që jetojnë jashtë vendit, dhe në këtë shifër nuk përfshihen edhe persona tjerë të cilët nuk janë lajmëruar për disa vite me radhë. Komuna ka faturuar dhe arkëtuar tarifën për mbeturina në shumë prej 12€/për vit, për amvisëritë e qytetarëve që jetojnë jashtë vendit pa ndonjë bazë ligjore (vendim të Kuvendit Komunal). Si rezultat i nënfaturimit komuna edhe këtë vit kishte mbledhë me pak të hyra në vlerë prej 162,456€, pasi ngarkesa e tarifës vjetore duhet të ishte 54€.

Shkak për këtë janë ankesat e familjeve jashtë vendit për të mos paguar njëjtë me të tjerët dhe përvoja e kompanisë e cila ka zbatuar këtë metodë duke u bazuar në faturën e gjendjes vjetore të rrymës, ku vërtetohet qëndrimi i familjarëve në shtëpi.

Ndikimi

Mos azhurnimi i të dhënave sipas gjendjes faktike në teren si dhe mos aplikimi i ngarkesave sipas kërkesave ligjore apo rregullores për grumbullimin e mbeturinave rrit rrezikun që të hyrat prej kësaj kategorie të jenë më të ulëta. Po ashtu intervenimi në bazën e sektorit të mbeturinave duke ndryshuar faturën nga 54€ në 12€ pa ndonjë gjurmë në sistem, lë hapësirë për keqpërdorim dhe po ashtu shkakton ngarkesë të llogarive të arkëtueshmeve.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë se do të kryhen analiza të mirëfillta nga menaxhimi i mbeturinave në mënyrë që të arrihen objektivat e komunës në krijimin e sistemit të qëndrueshëm financiar. Po ashtu, të merret në konsideratë që paraprakisht të rifreskohet data baza e ngarkesave si dhe të bëhen ndryshimet dhe aprovimet në rregullore nga organi legjislativ për lirim apo përcaktimin e tarifave për amvisëritë e caktuara.

2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 20,611,778€, i cili ishte i shpenzuar 97%. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 3,136 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 3,016. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar 87¹³ të rinj. Kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë 48,588, si dhe 13 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B4 - Mungesa e vërtetimit për kompensimin e shtesës për provojën e punës

Gjetja Vendimi i Qeverisë nr.06/29 i dt.15.05.2015 në paragrafin 6 kërkon një vendim të vërtetuar nga zyrtarët e autorizuar të personelit për dëshminë e viteve të përvojës së punës.

Në 16 raste në drejtorinë e shëndetësisë dëshmitë për vitet e përvojës së punës nuk ishin të pasqyruara me një vendim të vërtetuar nga zyrtarët e autorizuar të personelit, si bazë për kompensim. Kjo ka ndodhur si pasojë e pakujdesisë nga stafit përgjegjës për të kompletuar dosjet. Komuna për shtatë raste ka sjellë vendimet e përgatitura me dt. 01.06.2020 nga QKMF, për stafin shëndetësorë.

Ndikimi Pagesat e bëra për shtesën 0.5% në vite për përvojën e punës pa dëshmi përkatëse rrisin rrezikun e kompensimit jo real.

Rekomandimi B4 Kryetari të sigurohet se drejtorët e institucioneve shëndetësore dhe menaxheri i personelit duhet të kompletojnë dëshmitë për përvojën e punës për të krijuar bazë ligjore për ekzekutimin e shtesës në bazë të përvojës.

2.1.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2019 ishte 6,567,707€, prej tyre ishin shpenzuar 5,678,409€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shërbime kontraktuese tjera, shpenzime të udhëtimit zyrtar brenda vendit, furnizim për zyre, shpenzime komunale, shpenzime të derivateve etj. Kemi testuar 83 mostra për teste substanciale në vlerë 1,367,346€ si dhe 13 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B5 - Parregullsi në angazhimin e stafit për shërbime të veçanta

Gjetja Ligji nr. 03/L-212 i punës neni 10 paragrafi 6 parasheh "Kontrata për një detyrë specifike, nuk mund të jetë më e gjatë se njëqindnjëzet ditë brenda një viti, kurse Ligji nr. 03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës neni 12 paragrafi 4 "Emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura "Marrëveshje për shërbime të veçanta" të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një

¹³ Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës 50, Drejtoria e Shëndetësisë 18 dhe Administratën komunale 19 punonjës.

procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit”.

Në vitin 2019 komuna ka pranuar 41 punonjës me MSHV. Për 11 raste (të punësuar në njësi të ndryshme), komuna nuk kishte zhvilluar procedura të thjeshtësuar të rekrutimit, prej tyre gjashtë¹⁴ ishin rekrutuar sipas LSHC në vitin 2018 (për gjashtë muaj) duke iu vazhduar kontrata në vitin 2019 edhe për gjashtë muaj tjerë, kurse pesë¹⁵ raste të rekrutuar sipas LP në vitin 2018 (për katër muaj), duke iu vazhduar kontratat në vitin 2019 edhe për 4 muaj.

Bazuar në interpretimin e zyrës ligjore komunale, Kryetari ka marrë vendim për vazhdimin e këtyre kontratave në heshtje për shkak të ndjeshmërisë së disa punëve të cilat nuk ishin përfunduar.

Ndikimi

Angazhimet e tilla rezultojnë me parregullsi ligjore dhe mungesë të monitorimit, e cila ndikon që komuna të pranojë si kundërvlerë kontributin/performancën /shërbimin jo të duhur nga staf i angazhuar në këtë formë dhe në të njëjtën kohë është mungesë konkurrencës apo ofrimit të mundësisë për të konkuruar dhe zgjedhur sipas meritës.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të sigurojë se marrëveshjet për shërbime të veçanta të planifikohen drejt dhe angazhimet për këto shërbime të mos zgjasin më shumë se afati i paraparë ligjorë. Po ashtu kryetari duhet të sigurojë se punonjësit me kontrata për shërbime të veçanta do të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike.

Çështja A3 - Paqartësi rreth shërbimit të pranuar apo furnizimit të mallrave

Gjetja

Kontrata kornizë për “Menaxhimin e mbeturinave grumbullimi – transportimi, dhe deponimi i mbeturinave në komunën e Prizrenit” në tri lote, Loti A i nënshkruar me dt. 05.06.2017 me kohëzgjatje nga 01.07.2017 deri më 30.06.2019 në listën e çmimeve parasheh që shërbimi të kryhet për 24,685 amvisëri në vlerë

¹⁴Bashkëpunëtor profesional për mbledhjen e të dhënave në terren DES, Bashkëpunëtor profesional për mbështetje juridike, Bashkëpunëtorë për hartimin dhe analizimin e projekteve financiare dhe menaxheriale në drejtorinë e PMS në KP, Përfaqësues ligjor i komunës në zyrën e Kryetarit dy persona, dhe Bashkëpunëtor profesional për mbledhjen e të dhënave në terren DES.

¹⁵Ndihmës bashkëpunëtor për evidentimin e mbindërtimeve në objektet kolektive në D. e Inspektoratit, Ndihmese bashkëpunëtor për evidentimin e mbindërtimeve në objektet kolektive në D. e Inspektoratit Bashkëpunëtorë për regjistrim, seleksionim, plotësim dhe rregullimin teknik të kërkesave në D. e Inspektoratit dhe Bashkëpunëtorë për regjistrim, seleksionim, plotësim dhe rregullimin teknik të kërkesave në D. e Inspektoratit dhe Ndihmese bashkëpunëtor për evidentimin e mbindërtimeve në objektet kolektive në D. e Inspektoriatit

mujore 92,322€ apo 3,74€ për një amvisëri.

Komuna në tri pagesa për muajt shkurt, prill dhe maj të vitit 2019, bazuar në situacionet e pranuar (01.03.2019; 02.05.2019 dhe 03.06.2019) nga anëtarët e komisionit mbikëqyrës, përfshirë edhe personin e autorizuar nga furnitori (menaxherin e njësisë), figuronin të shërbyera vetëm 12,343 amvisëri, ndërsa faturimi dhe pagesa për këta muaj është bërë e plotë për 24,685 amvisëri. Komuna për këta tre muaj ka paguar 138,477€ (46,159€ në muaj), për shërbimet të cilat nuk janë pranuar/përfunduar. Komuna nuk ka lëshuar vërejtje për OE që nuk i ka kryer këto shërbime pasi që kjo është cilësuar si gabim teknik.

Kjo ka rezultuar si pasojë e mungesës së ushtrimit të kontrolleve adekuate nga ana e menaxherit të projekteve dhe mbikëqyrësve.

Ndikimi Dështimi i kontrolleve në menaxhimin e shpenzimeve rezulton me pagesa të parregullta dhe dëmtimin e buxhetit të komunës për shërbime të cilat nuk janë pranuar.

Rekomandimi A3 Kryetari i Komunës të siguroj që komisionet për pranimin e mallrave/shërbimeve të vendosura si pika të kontrollit, e shqyrtojnë paraprakisht të gjithë dokumentacionin dhe sigurohen se mallrat/shërbimet janë pranuar para se të lejohen urdhër pagesat. Në të kundërtën duhet të zbatohen masat për lëshimet e identifikuar dhe papërgjegjësinë e komisioneve.

Çështja A4 - Pa rregullësi në përdorimin e procedurës me vlerë minimale

Gjetja Neni 54.2 i Rregulles dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik përcakton që: Në llogaritjen e vlerës së kontratës për përdorimin e procedurës së vlerës minimale, autoriteti kontraktues do t'i marrë parasysh vetëm një grup të mallrave, shërbimeve apo punëve të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen së bashku dhe të cilat nuk duhet të ndahen me qëllim të përdorimit të një procedure të tillë; neni 54.9 Zyrtari i Prokurimit do t'ia jap dhe nxjerr urdhrin e blerjes atij operatori ekonomik që ka ofertuar çmimin më të ulët. Njoftimi për nënshkrim të kontratës do të përgatitet brenda dy ditësh pas nënshkrimit të kontratës dhe do ti dërgohet KRPP-se për publikim; dhe neni 54.11-Të gjitha aktivitetet e prokurimit me vlerë minimale duhet të përfshihen në Raportin Vjetor mbi Kontratat e nënshkruara Publike".

Në dy raste "Furnizim me material zyrtar" dhe "Mirëmbajtje të objekteve (material higjienik)", Drejtorët e shkollave (dy shkollave) kanë udhëhequr dhe nënshkruar kontrata me procedura të prokurimit me vlerë minimale nën 1,000€, ku këto lloje të kontratave po të mblidheshin së bashku për të gjitha shkollat, do të rezultonin në procedura të hapura të tenderëve me vlerë të mesme. Për më tepër për këto kontrata nuk ishin bërë njoftimet për nënshkrimin e tyre nga ana e menaxherit të prokurimit të Komunës së Prizrenit dhe këto kontrata nuk ishin

përfshirë në raportin vjetor të kontratave të nënshkruara.

Ndikimi Mënyra e kontraktimit dhe furnizimit më procedura më vlerë minimale që parashihet pa publikime të njoftimeve për kontratë rrit rrezikun furnizimit me çmime më të larta në krahasim më tregun dhe furnizimet mund të jenë me cilësi më të ulët, përveç që ndarja e tenderëve është edhe shkelje ligjore.

Rekomandimi A4 Kryetari i komunës të siguroj që janë vlerësuar nevojat e tërësishme të komunës për furnizime, shërbime të ngjashme dhe të lidh kontratë të përbashkët më qëllim të kontraktimit me çmime më të favorshëm për komunën dhe sigurimin e cilësis më të lartë të furnizimit.

Çështja A5 - Fituesi i kontratës me obligime ndaj ATK-së

Gjetja Në njoftimin për kontratë "Furnizim me GPS për veturat zyrtare të Komunës së Prizrenit" të dt.19.03.2019 në kërkesat për pranueshmërinë e tenderëve është paraparë dorëzimi i vërtetimit nga ATK (kopje). Vërtetimi tatimor me nr. 1000588350 i dt.13.05.2019 tregonte që operatori ekonomik i shpërblyer me kontratë, kishte borxhe tatimore të pashlyera. Kontrata është nënshkruar më dt. 28.05.2019 në vlerë 8,136€.

Ndikimi Shpërblymi me kontratë i OE të papërgjegjshme rrit rrezikun që operatori të përballet me vështirësi financiar për pagesën e borxheve që ka ndaj shtetit dhe kontrata të mos realizohet apo AK të dështoj për të marr shërbimin apo pranuar mallin me kohë sipas planifikimit.

Rekomandimi A5 Kryetari të siguroj që menaxheri i prokurimit nuk nënshkruan kontrata pa siguruar se janë plotësuar dhe kushtet e pranueshmërisë së tenderëve.

2.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 702,700€, prej tyre ishin shpenzuar 701,262€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me subvencionimin e entiteteve publike dhe jo publike, pagesat për sektorin e blegtorisë, pagesat për kulturat etj. Kemi testuar nëntë mostra për teste substanciale në vlerë 98,069€ si dhe 10 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A6 - Mangësi gjatë subvencionimit të OJQ-ve

Gjetja Shpallja publike për financim të OJQ-ve nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e dt.08.02.2019 ishte përcjellur me këto mangësi:

- Neni 10 pikat 1.2, 1.4 dhe 1.5 të rreg. MF 04/2017 mbi Kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik, përcaktojnë kriteret e përgjithshme minimale (certifikaten, numrin fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të R. së Kosovës, deklaratën e financimit të dyfishtë dhe

deklarata e konfliktit të interesit për t'u kalifikuar për mbështetje financiare publike).

Komuna në këtë shpallje publike nuk i kishte vendosur këto kritere për t'u plotësuar nga OJQ-të, për më tepër nuk kishte caktuar zyrtarin për monitorimin e zbatimit të kontratës¹⁶.

- Sipas pikës 3 të shpalljes publike të lartëcekur ishte kërkuar "Dëshmi që nuk ka obligime ndaj ATK-së (për persona juridik)" ndërsa sipas pikës 5 kriteri për aplikim ishte se "Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja, ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve, nese është e aplikueshme".

Në gjashtë¹⁷ dosje të aplikantëve mungonte vërtetimi i ATK-së për obligimet tatimore, dhe në nëntë raste mungonin vërtetimet nga gjykata se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, para nënshkrimit të kontratave.

Kjo situatë është pasoj e mungesës së kontrolleve dhe pakujdesisë së komisionit të themeluar për vlerësimin e aplikacioneve.

Ndikimi

Mungesa e përfshirjes së kriterëve minimale në shpalljen publike rezulton me diskriminimin e të interesuarve dhe kufizim të konkurrencës. Përzgjedhja e përfitueseve, pa i plotësuar kriteret e vendosura në shpalljen publike ka reflektuar trajtim jo të barabartë të aplikuesve dhe komuna rrezikon financimin e përfituesve të papërgjegjshëm, përmes fondeve publike.

Rekomandimi A6 Kryetari duhet të siguroj që ka transparencë në procedura dhe vendimmarrje në gjithë ciklin e ofrimit të mbështetjes financiare, duke përfshirë publikimin e kriterëve dhe procedurave, aplikimin, vendimmarrjen dhe përzgjedhjen e përfituesve. Çdo ofrues i mbështetjes financiare (komuna) që planifikon mbështetje financiare për OJQ-të duhet të disponojnë me kapacitete institucionale, duke përfshirë burimet e nevojshme njerëzore për të zbatuar kërkesat ligjore. Komisioni Vlerësues të përbëhet nga anëtarë që kanë përvojë dhe integritet, me mandat për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve, në të kundërtën duhet të zbatohet parimi i llogaridhënies për shfrytëzimin e këtyre fondeve.

¹⁶ Sipas planit ishte paraparë që 80 OJQ të financohen nga drejtoria për kulturë rini dhe sport. Nr. përfitues i OJQ-ve nga kjo thirrje është 54 me vlerë totale 104,900€. Kontratat janë nënshkruar në Maj dhe Qershor 2019.

¹⁷ Festivali "Hasi Jehonë"; Fondacioni "Lumbardhi"; Ipsia; Shka "Agimi"; SHMP "Shadarëvani"; OVL e UÇK.

2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale në 2019 ishte 21,862,010€, prej tyre ishin shpenzuar 15,642,244€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve lokale, mirëmbajtjen investive, objektet arsimore, pajisje tjera etj. Kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë 4,923,915€, si dhe 23 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B6 - Mungesa e projektit ekzekutiv

Gjetja Neni 20 pika 10 i Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (UOPP) kërkon që "Specifikat teknike për kontratën e punës, duhet të përfshijnë një projekt ekzekutues si pjesë substanciale të veten". Ndërsa, pika 13 "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet ti bashkëngjitet specifikave teknike të cilat janë pjesë e dosjes së tenderit". Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Në kontratën "Punimi i kabineteve në nënkuilin e shkollës fillore në Mushnikovë të Prizrenit" në vlerë prej 107,945€, komuna nuk e kishte hartuar projektin ekzekutiv, por kishte iniciuar procedurat e prokurimit duke përgatitur vetëm paramasën dhe parallogarinë. Shkaqet e mos hartimit të projektit ishin neglizhenca e zyrtarëve përkatës dhe fakti që procedurat e prokurimit të mos vonohen.

Ndikimi Zhvillimi i procedurave të prokurimit pa projekt ekzekutiv, rrisin rrezikun e realizimit të punëve pa kritere standarde të ndërtimit, vonesa në realizimin e tyre dhe të mos arrihet cilësia e duhur.

Rekomandimi B6 Kryetari duhet të sigurojë që hartimi i projekteve ekzekutive të realizohet në pajtim me kërkesat ligjore, gjegjësisht hartimin e tyre para inicimit të procedurave të prokurimit.

Çështja B7 -Pamjaftueshmëria e mjeteve të zotuarra për pagesën e faturave

Gjetja Sipas rregullës financiare Nr. 01/2013 për shpenzimin e parasë publike “asnjë kontratë publike nuk duhet të nënshkruhet pa zotim të mjeteve” gjithashtu “organizata buxhetore nuk ndërmerr asnjë obligim gjate vitit aktual fiskal në një shumë që i tejkalon fondet e ndara”.

Nga 100 mostra të testuara, në tri¹⁸ raste komuna kishte pranuar faturën tatimore së bashku me dokumentacionin mbështetës para datës së kërkesës për zotim të mjeteve dhe kërkesës për mallra dhe shërbime. Vlera e faturave të pranuar është 254,160€. Shkaku i një dukurie të tillë është planifikimi jo adekuat i buxhetit dhe inicimi i procedurave duke shpërfillur zbatimin e rregullave në fuqi.

Ndikimi Hyrja në obligime pa fonde të zotuarra rezulton në pamundësinë e financimit në tërësi të këtyre projekteve. Kjo mund të rezultojë me dështim të realizimit të tyre.

Rekomandimi B7 Kryetari i Komunës të siguroj kontrollë të shtuara që para nënshkrimit të kontratave të bëhet zotimi i mjeteve në mënyrë që të eliminohet praktika e pranimit të mallit dhe punëve pa zotim të mjeteve.

Çështja B8 - Mos-vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit konform periudhës së zbatimit të kontratës

Gjetja Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimit Publik, neni 30 përcakton: “Siguria e ekzekutimit është paraparë të mbështetë përmbushjen e kontratës. Shuma e sigurimit të ekzekutimit do të jetë e barabartë me të paktën 10% të vlerës së kontratës. Sigurimi i ekzekutimit do të mbetet valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës”. Po të njëjtin obligim ligjor komuna e kishte përfshirë edhe te kushtet e veçanta të kontratave, për punë (në nenin 1.18).

Në katër¹⁹ raste, komuna përkatësisht zyra e prokurimit nuk kishte kërkuar vazhdimin e sigurimit të ekzekutimit të kontratës, krahas shtyrjes së periudhës së ekzekutimit apo periudhës sa kontrata ishte aktive. Shkaku i një dukurie të

¹⁸ Ndërtimi i aneksit të objektit shkollor “Dëshmorët e Vërrinit” në Billushë-Prizren, situacioni XII vlera pagesës: 40,102.86 €; Ndërtimi i kanalizimit fushor në fshatin Krushë e Vogël, situacioni IV, vlera pagesës: 44,715.14 €; Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Ekonomik në Lubizhdë të Prizrenit, situacioni I-rë, vlera pagesës: 132,941.14€.

¹⁹ Ndërtimi i ambientit në Kabash dhe Korishë si destinacion turistik”, vlera 71,087€, mungesë e sigurisë së ekzekutimit për 200 ditë kalendarike; Ngritja e 50 serrave me participim për fermerët e Komunës së Prizrenit, vlera 161,720€, mungesë e sigurisë së ekzekutimit për 85 ditë kalendarike; Renovimi i Objektivit të zjarrfikësve në komunën e Prizrenit, vlera:26,666.66€, mungesë e sigurisë së ekzekutimit për 280 ditë kalendarike dhe Ndërtimi i infrastrukturës rrugore në lagjen Bajram Curri në Prizreni, vlera 626,704.29€ mungesë e sigurisë së ekzekutimit për 210 ditë kalendarike.

tillë ishin vonesat në realizimin e kontratave dhe neglizhenca e zyrtarëve përkatës për të ripërtërirë sigurimin e ekzekutimit për kontratat përkatëse, përkatësisht mungesa e komunikimit në mes të menaxherëve të kontratave dhe Zyrës së Prokurimit.

Ndikimi Mungesa e sigurisë së ekzekutimit përveç që është anashkalim ligjor, rrit rrezikun që autoriteti kontraktues të mos ketë mbulesë për dëmet dhe shpenzimet eventuale të mundshme që mund të rrjedhin gjatë periudhës së shtyrë për implementimin e këtyre kontratave.

Rekomandimi B8 Kryetari duhet të siguroj përmes zyrtarëve përgjegjës, që çdo projekt të realizohet brenda kornizës kohore të përcaktuar në kontrata dhe se sigurimi i ekzekutimit duhet të ketë vlefshmëri në raport me periudhën e përmbushjes së kontratës ashtu siç parashihet në ligj.

Çështja A7 - Ndryshimi i pozicioneve të paramasës jo në pajtueshmëri me procedurat ligjore

Gjetja Sipas nenit 61 pikave 21, 22 dhe 23 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për prokurimin publik, “ndryshimi i kontratës i referohet një ndryshimi në termat dhe kushtet e një kontrate të shpërblyer. Ndryshimi i kontratës iniciohet nga menaxheri i kontratës. Aty ku ndryshohet kontrata me qëllim të ndryshimit të termave dhe kushteve fillestare, ndryshimi i kontratës do të përgatitet nga departamenti i prokurimit. Ndryshimi i kontratës nuk do t’i lëshohet operatorit ekonomik para marrjes së aprovimit nga ZKA”.

Në dy²⁰ raste për kontratat jo kornizë, komuna kishte ekzekutuar pagesën për pozicionet të cilat ishin ndryshuar krahas paramasës së kontraktuar. Pra organi mbikëqyrës përkatësisht menaxheri i kontratës, nuk kishte respektuar paramasën dhe parallogarinë e kontratës bazë, i njëjti nuk kishte respektuar procedurat ligjore me rastin e ndryshimit-tejkalimit të pozicioneve. Ky ndryshim/plotësim i pozicioneve nuk ka tejkaluar vlerën totale të kontratës.

Planifikimi dhe hartimi jo-adekuat i projekteve nga ana e Autoritetit Kontraktues, ka shtyrë që të ndryshohen pozicionet brenda paramasës së kontraktuar. Gjithashtu neglizhenca nga ana e Menaxherit të projektit ka bërë që mos të ndiqen procedurat përkatëse ligjore me rastin e ndryshimit të pozicioneve.

Ndikimi Ndryshimi-tejkalimi i pozicioneve të përcaktuara paraprakisht në marrëveshje kontraktuale pa aprovimin e ZKA-së shpërfaq mungesë të kontrolleve dhe menaxhim të dobët të kontratës. Dhe si e tillë rrit rrezikun që OE të mos kryej

²⁰ Ndërtimi i ambientit në Kabash dhe Korishë si destinacion turistik; vlera:71,087€ p.sh. pozicioni 3.3 tejkalim 2,363€, pozicioni 4.4 realizuar më pak për 3,000€ dhe Ndërtimi i infrastrukturës në rrugën Ali Pashë Tepelena në Prizren; vlera: 34,195.14€ p.sh. pozicioni 4.1 tejkalim 504€, pozicioni 5.2 realizuar më pak për 1,560€.

punët sipas standardeve dhe cilësisë së kërkuar.

Rekomandimi A7 Kryetari përmes menaxherëve të kontratave duhet të sigurohet që fillimisht të mos lejoj ndryshime-tejkalime të pozicioneve të paramasave të kontraktuara, dhe nëse paraqitet nevoja për ndryshime të raportohet për çdo devijim nga termat dhe kushtet e kontratës. Po ashtu, çdo ndryshim në kushtet e kontratës duhet të arsyetohet në detaje nga menaxheri i projektit, përgatitet nga prokurimi dhe aprovet nga nivelet relevante.

Çështja B9 - Vonesa në ekzekutimin e kontratave

Gjetja Sipas Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik, pikat 61.6, 61.19 dhe 61.20 përcaktojnë se: "Menaxherët e kontratës janë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe duhet të sigurojnë se OE kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Secila kontratë publike ka të përcaktuar afatin kohor të implementimit.

Në tri²¹ raste punimet nuk ishin realizuar sipas afateve të përcaktuara me kontrata. Në asnjë rast nuk ishin aplikuar penalet për mos përfundimin e punëve me kohë. Më tutje, menaxheret e këtyre kontratave nuk kishin raportuar vonesat, si dhe nuk kishin ofruar asnjë arsyeshmëri për këto vonesa.

Shkak i vonesave ishte mungesa e mjeteve në dispozicion për të përfunduar kontratën si pasojë e planifikimit jo të duhur të projektit. Gjithashtu si shkak të tjerë janë evidentuar edhe disa konteste pronësore në terren përgjatë realizimit të projektit.

Ndikimi Vonesat në realizimin e kontratave rrisin rrezikun që obligimet kontraktuale të barten për tu paguar në vitet e ardhshme, të cilat do të jenë barrë për buxhetin e viteve në vijmë. Po ashtu, mos kompletimi i dokumentacionit sipas kërkesave ligjore, vonesat e pa arsyetuara, mungesa e dëshmimeve për vazhdim të afatit dhe mos aplikimi i penaleve tregon se ka dobësi në aplikimin e kontrolleve për menaxhimin adekuat të kontratave.

²¹ 1. Titulli i projektit: Krijimi i ambientit në Kabash dhe Korishë si destinacion turistik, vlera e kontratës, 71,087€, dt. e nënshkrimit të kontratës 15.11.2018, plani dinamik 60 ditë pune, afati për përfundimin e punëve 13.02.2019, vonesa 155 ditë pune; 2. Titulli i projektit Ndërtimi i infrastrukturës rrugore në lagjen Bajram Curri, vlera e kontratës 626,704.29€ dt. e nënshkrimit të kontratës 10.10.2017, plani dinamik, 18 muaj kalendarik, afati për përfundimin e punëve 10.04.2019, vonesa projekti ende i pa përfunduar; dhe 3. Titulli i projektit Ngritja e 50 serrave me participim, vlera e kontratës 161,720€, dt. e nënshkrimit të kontratës 18.07.2018, plani dinamik 90 ditë pune, afati për përfundimin e punëve 21.11.2018, vonesa projekti 85 ditë pune.

Rekomandimi B9 Kryetari duhet të sigurojë që paraprakisht të eliminohen kontestet pronësore, të sigurohen fondet e nevojshme, planifikimi i mirëfilltë si dhe të forcohen kontrollet në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve në mënyrë që ato të përfundohen me kohë sipas planit dinamik. Aty ku është e nevojshme, të zbatohen masat ndëshkuese sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

2.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

Çështja B10 – Dobësi në menaxhimin e pagesave

Gjetja Neni 24 i rreg. 01/2013 për shpenzimin e parasë publike, parasheh që të gjitha faturat duhet të pranohen duke zbatuar procedurat e kontrollit të brendshëm për qarkullim të dokumentacionit dhe neni 25 pika 1.4 - para së të regjistrohet shpenzimi në SIMFK, dokumentacioni për pagesë dorëzohet te zyrtari certifikues, i cili është përgjegjës që dokumentacioni të jetë i kompletuar dhe janë zbatuar të gjitha nivelet e kontrollit të brendshëm financiar.

- Te kategoria e investimeve kapitale në tri²² raste komuna kishte realizuar pagesat sipas faturave përkatëse në vlerën prej 217,759€, përderisa në analizën e raporteve të pranimit të punëve dhe situacioneve rezultoi që obligimi për pagesë të jetë 203,062€. Mbi pagesa për shumën 14,697€ ishte rezultat i neglizhencës nga ana e organit mbikëqyrës për mos barazimin aritmetikor dhe kontrollit të dobët nga ana e zyrtarëve përkatës. Pas identifikimit të çështjes nga auditori, Komuna ka dorëzuar dëshmi se për “Ndërtimin e aneksit të objektit shkollor, Dëshmorët e Vrrinit”, kompania ka kthyer mjetet në vlerë prej 485€ me dt. 24.07.2020. Për “Ndërtimin e Parkut ekonomik” organi mbikëqyrës ka bërë ndryshime në situacionin e I aksi 3-3” me dt.20.06.2020 të nënshkruar edhe nga kompania, duke zbatuar vlerën e kalkuluar gabimisht prej 7,300€ (me datë 20.12.2019) për punët që janë kryer pas pagesës së identifikuar nga auditori. Për rastin e tretë Komuna nuk ka ofruar dëshmi shtesë.

²²Ndërtimi i aneksit të objektit shkollor “Dëshmorët e Vrrinit” në Billushë-Prizren, situacioni XII vlera e pagesës: 40,102.86€; Ndërtimi i kanalizimit fushor në fshatin Krushë e Vogël, situacioni IV, vlera pagesës 44,715.14€; Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Ekonomik në Lubizhdë të Prizrenit, situacioni I-rë, vlera pagesës 132,941.14€.

- Po ashtu nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve te kontrata “Transporti i mësimdhënësve udhëtar dhe të punësuarve në administratën komunale të Prizrenit”, në dy pagesa të kësaj kontrate përkatësishtë fatura me numër 09-DA/2019 të dt. 01.10.2019 dhe të fatura me numër 11-A-DA/2019 të dt. 07.11.2019, ishin përfshirë dhe paguar dy herë shërbimet e kryer nga data 15.09.2019–30.09.2019, përkatësisht 11 ditë pune në vlerë financiare $11 \times 126.70 = 1,394\text{€}$. Kjo ka ndodhur si pasojë e mosfunksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme gjatë mbikëqyrjes dhe procesimit të pagesave.

Ndikimi

Realizimi i pagesave pa zbatuar kontrollet e brendshme ka reflektuar me daljen e pa rregullt të parasë apo shpenzimin e buxhetit për punët /shërbimet që nuk janë realizuar/pranuar. Gjithashtu shpenzimi i buxhetit i destinuar për këtë kategori reflekton me performancë jo reale dhe prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në PFV.

Rekomandimi B10 Kryetari duhet të sigurojë që për të gjitha shpenzimet paraprakisht personat përgjegjës ushtrojnë kontrollet adekuate, në mënyrë që të bëjnë barazimet e nevojshme para realizimit të pagesave.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 486,187,868€, pasurive jokapitale është 1,222,726€, si dhe e stoqeve 261,797€. Kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë 1,910,356€, si dhe pesë mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja C2 - Mangësi në menaxhimin e pasurisë

Gjetja

Lidhur me menaxhimin e pasurive kemi identifikuar si në vijim:

- Regjistri i e-pasurisë nuk është i plotë për arsye se blerjet nga sektori i QKMF-së, Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Arsimit edhe pse mbahen në regjistra të brendshëm, të njëjtat nuk regjistrohen në softuerin e e-pasurisë, siç është paraparë me Rregulloren Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Financiare neni 6 pika 1 dhe 2. Përkundër shtimit të kapaciteteve njerëzore dhe ngritjes së kapaciteteve teknike mungesa e komunikimit brenda departamenteve ka rezultuar që ky regjistër të mos jetë i plot.
- Komisioni për inventarizimin e pasurisë edhe pse kishte dorëzuar raportin, nuk kishte harmonizuar gjendjen e inventarizimit me gjendjen e pasurisë në regjistrat kontabël. Shkaku i mos harmonizimit ishte mungesa e njohurive ligjore, gjithashtu mangësitë në regjistrat e pasurisë të përcjelluara nga vitet paraprake kanë pamundësuar harmonizimin përkatës që parashihet me Rregulloren 02/2013, përkatësisht neni 19, paragrafit 6 ku “të gjitha ndryshimet në numrin ose vlerën e pasurive të cilat përcaktohen pas

inventarizimit duhet të pasqyrohen në regjistrin e pasurive dhe në regjistrin kontabël”.

- Pas përfundimit të vitit, komuna kishte themeluar komisionin për vlerësimin e pasurive si kërkesë e dalur nga raporti i inventarizimit të pasurive jo financiare, i cili nuk kishte arritur të përfundojë punën me kohë sikurse parashihet në nenin 21 të Rregullores 02/2013. Shkaku i vonesave të tilla ishte neglizhenca e personelit përgjegjës.

Ndikimi

Mangësitë në regjistrimin e plotë të pasurisë duke mos përfshirë të gjitha blerjet, vështirësojnë identifikimin e pasurive për të konfirmuar ekzistencën, prejardhjen dhe pronësinë e tyre. Po ashtu, mungesa e raportit për vlerësimin e pasurisë ndikon në mos harmonizimin e gjendjes së inventarizimit me gjendjen në regjistrin kontabël gjë që mangësitë e identifikuar reflektojnë me nënvlerësim dhe në shpallje jo të drejtë të pasurive në PFV.

Rekomandimi C2 Kryetari duhet të sigurojë që kërkesat në lidhje me regjistrimin dhe mirëmbajtjen e pasurive duhet të aplikohen në tërësi, ku përmes sistemit e-pasuria evidentohen të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme (me vlera nën 1,000€) për të gjitha dikasteret komunale. Po ashtu, duhet të sigurojë që raportet e komisionit të inventarizimit dhe ai i vlerësimit të finalizuar, të harmonizohen me gjendjen e pasurisë në regjistra dhe të paraprijnë përgatitjes së PFV, në mënyrë që vlera e pasurisë të prezantohet saktë.

2.3 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme në fund të vitit 2019 ishin 19,683,675€, në këtë janë të përfshira tatimi në pronë në vlerë 8,174,720€, taksat për firma 7,101,517€, mbeturinat 3,476,272€ dhe qiraja nga lokalet, tregjet dhe tavolinat 913,367€²³. Krahasuar me vitin 2018 (18,931,287€) kemi rritje të LLA prej 751,848€ apo 4%.

Çështja C3 – Nënvlerësimi i llogarive të arkëtueshmeve dhe menaxhim jo i duhur i tyre

Gjetja

Lidhur me menaxhimin e LL/A identifikuam si në vijim:

- Komuna në PFV-të e vitit 2019 ka prezantuar 8,057,501€ llogari të arkëtueshme për tatimin në pronë. Gjatë analizës së kësaj llogarie, kemi vërejtur se komuna nuk ka harmonizuar saldot përfundimtare të kartelës së llogarive të arkëtueshme për tatimin në pronë me saldote fillestare, duke nënvlerësuar këto llogari për 117,220€. Shpallja në PFV konsiderohet jo e saktë dhe e plot për shkak të këtij nënvlerësimi.

²³ Lokalet 594,132€, tregjet 183,968€ dhe tavolinat 135,267€.

- Komuna përballet me vlerë të lartë të llogarive të arkëtueshme mbi 19.6 milion€, që rriten nga viti në vit. Llogaritë e arkëtueshme më të theksuara janë nga tatimi në pronë, taksat në firmë, të hyrat nga mbeturinat si dhe borxhet nga qiratë. Në mars të 2019, komuna ka caktuar një komision për një periudhë gjashtë mujore, për evidentimin dhe inkasimin e llogarive të arkëtueshme, i cili kishte përgatitur një raport në gusht të vitit 2019 me disa rekomandime se si të veprohet në rritjen e inkasimit. Pas prezantimit në Kuvendin Komunal, tek në nëntor ky raport ju është prezantuar të gjitha drejtorive. Departamenti i tatimit në pronë ka bërë 116 marrëveshje për pagesë me këste dhe ka dërguar 48 njoftime përfundimtare për pagesën e borxhit të tatimit në pronë, mirëpo trajtimi i tyre ende vazhdon të mbetet sfidë për tërë komunën.

Mungesa e mekanizmave adekuatë, aplikimi i vonuar i masave për t'i arkëtuar këto të hyra dhe përgjegjësa jo e mjaftueshme e personave kompetent, ishin shkaktar të kësaj situatë.

Ndikimi Nënvlërimi i LL/A ka ndikuar në shpalljen jo të drejtë të tyre në PFV. Arkëtimi i borxheve nga debitorët, janë bërë barrë dhe të pa menaxhueshme për komunën duke shkaktuar probleme në përmbushjen e planit të shpenzimeve, ndërsa vjetërsia e tyre zvogëlon gjithnjë e më shumë gjasat që këto llogari të arkëtohen.

Rekomandimi C3 Kryetari duhet të sigurojë që llogarit e arkëtueshme të shpallura në PFV të harmonizohen me raportet financiare mbi tatimin në pronë të verifikuar paraprakisht për plotësin dhe saktësinë e tyre. Të shqyrtoj në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.

2.4 Detyrimet

2.4.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2019, ishte 1,307,932€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020. Për këto, ne kemi vërejtur si në vijim:

Çështja B11 - Nivel i lartë i obligimeve të paguara jashtë afatit ligjor

Gjetja Sipas Rregullës Financiare 01-2013 MF- Shpenzimi i parave publike, OB duhet që çdo faturë të vlefshme për pagimin e mallrave dhe shërbimeve, punëve të pranuar ta paguaj brenda 30 ditësh kalendarike nga data e pranimi të faturës. Nga analiza e bazës së furnitorëve në 1,252 raste në vlerë prej 4,369,850€²⁴ kemi

²⁴ Këtu përfshihen faturat që kanë kaluar afatin ligjor për pagesë mbi 30 ditë.

identifikuar se ishte tejkaluar afati ligjor për pagesë, obligime të komunës që datojnë nga 2009.

Shkaku i kësaj dukurie ishte hyrja në obligime pa fonde të mjaftueshme, mos planifikim i pagave jubilarë dhe mos funksionimi i kontrolleve të brendshme.

Ndikimi Si pasojë e vonësive të pagesave dhe mungesës së informacioneve të plota, mund të dobësohet aftësia e komunës për të parashikuar dhe menaxhuar nevojat për likuiditet. Po ashtu, komuna mund të përballet me kosto shtesë të interesave e gjobave për vonesat në pagesa.

Rekomandimi B11 Kryetari duhet të forcojë kontrollet në procesin e menaxhimit të pagesave për të siguruar që komuna nuk hyn në obligime pa fonde të mjaftueshme dhe të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor.

Çështja A8 - Mbivlerësim i obligimeve të papaguara

Gjetja Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore, neni 17.3 “Organizatat buxhetore raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) të krijuara deri më 31 dhjetor të vitit raportues”.

Nga auditimi i 18 mostrave, 13²⁵ prej tyre në vlerë 760,579€ nuk plotësonin kriteret për cilësimin e tyre si obligime të papaguara në PFV-të e vitit 2019. Malli-shërbimi/puna apo fatura nuk i takonin vitit 2019 (faturat ishin pranuar në vitin 2020).

Kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së ZKF për të kërkuar saktë referencat për njohjen e obligimeve (faturat dhe raportet e pranimit).

Ndikimi Prezantimi i gabuar i faturave ndikon në shpalosjen e pa drejt të obligimeve në PFV. Obligimet e prezantuar janë mbivlerësuar dhe rezultojnë me informata jo reale për vendimmarrësit.

Rekomandimi A8 Kryetari të sigurojë që prezantohen saktë në shpalosje vetëm obligimet të cilat kanë raport të përfundimit të punëve/shërbimeve apo furnizimeve para lëshimit të faturës, duke siguruar që të prezantohen drejtë ato.

2.4.2 Detyrimet kontigjente

Pasqyra e detyrimeve kontigjente në fund të vitit 2019, ishte 6,504,686€.

²⁵ Furnizimi me material për renovim të shtëpive të familjeve skamnore, Organizimi i panairit, Zhvillimi i turizmit kulturor, Ndërtimi i çerdhës për fëmijë në Prizren, Ndërtimi i QMF-së në fshatin Gjonaj, Politikat zhvillimore të sportit, Ngritja e stallave për bagëti të imta me participim etj.

Çështja A9 - Prezantimi jo i plotë i detyrimeve kontigjente

Gjetja Neni 18 i Raportit Vjetor Financiar për Organizatat Buxhetore parasheh prezantimin e detyrimeve kontigjente dhe shpalosjen në detaje të shënimeve në tabelë.

Bazuar në dëshmitë e pranuar nga komuna, detyrime kontigjente vetëm për vitin 2019 ishin në vlerë 6,099,075€. Duke pas parasysh detyrimet kontigjente aktive të vitit 2018 në vlerë 3,610,870€ dhe të vitit 2017 në vlerë 986,165€, totali i detyrime kontigjente në PFV e vitit 2019 do të duhej të prezantohet në vlerë totale prej 10,696,110€. Pra komuna ka nënvlerësuar 4,191,424€ detyrimet e shpalosura në PFV-të e këtij viti.

Ndikimi Mungesa e prezantimit të plotë të detyrimeve kontigjente (pasive gjyqësore) që janë në proces të shqyrtimit (aktive) shkakton nënvlerësim të tyre dhe për pasoj mos planifikimin e duhur të buxhetit për mbulimin e detyrimeve financiare në rast të humbjes së këtyre kontesteve.

Rekomandimi A9 Kryetari duhet të siguroj që detyrimet kontigjente janë prezantuar drejtë në PFV. Duhet të sigurohen të dhënat e sakta dhe të plota mbi këto detyrime nga zyra ligjore dhe të njëjtat të përcillen në zyrën e financave si hartuese të PFV.

2.4.3 Detyrimet kontraktuale

Detyrimet kontraktuale të raportuara nga ana e Komunës në fund të vitit 2019 janë në vlerë prej 3,800,940€²⁶.

²⁶ Kjo shumë e detyrimeve kontraktuale i përfshin: Arsimi 99,421€; Bujqësia 322,489€; Kultura 436,076; Shëndetësia 135,789€; Shërbimet sociale 215,639; Administrata 221,310€; Shërbimet publike 1,387,928€ dhe Turizmi 982,285€, vlerë e prezantuar nga komuna e Prizrenit, të cilën ne nuk kemi arritur të auditojmë.

2.5 Funksioni i auditimit të brendshëm

Njësia e auditimit të brendshëm (NJAB) operon vetëm me një anëtar – Drejtori i NJAB-së. Në Planin Vjetor të Auditimit, ishin planifikuar gjashtë²⁷ auditime të rregullta dhe një auditim me kërkesën e menaxhmentit dhe të gjitha ishin përfunduar. Ato kishin mbuluar fusha të ndryshme.

Komiteti i auditimit ka mbajtur tri takime konsultative dhe tri takime të rregullta, i cili me aktivitetet e tij kishte arritur të sigurojë fuqizimin e rolit të auditimit të brendshëm.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2018 për Komunën e Prizrenit ka rezultuar në 29 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planet e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna.

Komuna ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve me dt.27.09.2019 raportin e parë dhe dt.23.03.2020 me tetë ditë vonesë raportin e dytë për shkak të situatës pandemike, sipas kërkesave të daluara nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Deri në fund të auditimit për vitin 2019, tetë rekomandime janë zbatuar, tri ishin pjesërisht të zbatuara, gjashtë ishin rekomandime të mbyllur dhe 12 nuk janë zbatuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

²⁷ Auditime të rregullta si: 1. Auditimi i Mallrave dhe Shërbimeve dhe Komunalit në administratën komunale, 2. Auditimi i parasë së imët, 3. Auditimi i prokurimit, 4. Auditimi i të hyrave nga mbeturinat, 5. Auditimi i pasurisë dhe 6. Auditimi i Tatimit në pronë. Auditimi me kërkesë: 1. Auditimi i klubeve sportive KF "Liria" dhe KB "Bashkimi".

Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	<p>Kryetari duhet të sigurojë që është bërë një analizë për të përcaktuar arsyet për theksim të çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për të adresuar dobësitë në regjistrimin dhe prezantimin e drejte të shpenzimeve dhe eliminuar dobësitë në shpalosjen e plot të pasurisë, obligimeve dhe llogarive të arkëtueshme të prezantuara si theksimi i çështjes te opiniononi i auditimit.</p> <p>Gjithashtu, kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.</p>	Menaxhmenti kishte ndërmarrë disa veprime në lidhje me keq klasifikimet e shpenzimeve, mirëpo edhe këtë vit përballet me vlerë të lartë të keq klasifikimeve të cilat kanë ndikuar në theksimin e çështjes.	Rekomandim i pazbatuar.
2	Niveli i Realizimi Buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.	Çështja është mbyllur sa i përket këtij rekomandimi.	Rekomandim i mbyllur.
3	Të hyrat Qarkullimi i mjeteve jo përmes LIVTH	Kryetari duhet të veproj, marr masa për të rregulluar menaxhimin financiar të bibliotekës duke futur në sistem këtë njësi. Pranimi i mjeteve publike duhet të depozitohen në llogarinë zyrtare bankare të përcaktuar nga Thesari dhe shpenzimi i këtyre	Çështja është rregulluar nga dëshmitë e ofruar nga Biblioteka.	Rekomandim i zbatuar.

		mjeteve duhet të bëhet në përputhje me rregullat.		
4	Mos barazimi i të hyrave në mes drejtorive	Kryetari duhet të sigurojë se barazimet në mes të drejtorive përkatëse kryhen në baza të rregullta mujore dhe të gjitha mospërputhjet e mundshme të sqarohen me kohë.	Barazimit me drejtorit nga muaji Janar i vitit 2019 bëhen në mënyrë të rregullt.	Rekomandim i zbatuar.
5	Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë.	Kryetari duhet të vendos kontrole të qëndrueshme që sigurojnë një arkëtim efektiv të të hyrave, duke përfshirë dhe përcaktuar vlerësimin e drejtë të barrës tatimore në përputhje me rregullat dhe gjendjen faktike në teren duke angazhuar anketues kompetent.	Sistemi i tatimit në pronë protax ka rregulluar zbritjen në mënyrë automatike, mirëpo kemi ende raste që zbritja është aplikuar pa numër personal.	Pjesërisht i zbatuar.
6	Mangësi në llogaritjen e bazës së tatimi në pronë	Kryetari duhet të siguroj veprime shtesë si dhe të marrin veprim iniciues për përditësimin e rregullores në Asamblenë Komunale si dhe ndarjen e duhur të këtyre zonave tatimore me gjendjen faktike në teren.	Është bërë rregullorja e re nga MF ku ka bërë ndarjen e zonave.	Rekomandim i zbatuar.
7	Dobësi në menaxhimin e kontratave me koncesion dhe qiradhënie	Kryetari duhet të shqyrtoj arsyet e gjendjes ekzistuese dhe të vendos masat e duhura që brenda një periudhe të arsyeshme të arkëtoj të gjitha borxhet e prapambetura, ose në të kundërtën, të ndaloj shfrytëzimin e pronave publike pronarëve, të cilët nuk i kanë kryer obligimet ndaj Komunës.	Komuna nuk ka ndërmarr aktivitetet e nevojshme.	Rekomandim i pazbatuar.
8	Dobësi në menaxhimin e të hyrat nga sektori i mbeturinave	A4-Kryetari duhet të sigurojë se do të kryhen analiza të mirëfillta nga menaxhimi i mbeturinave në mënyrë që të arrihen objektivat e komunës në krijimin e sistemit të qëndrueshëm financiar. Po ashtu, të merret në konsideratë që paraprakisht të rifreskohet data baza e ngarkesave si dhe të bëhen ndryshimet dhe aprovimet në rregullore nga organi legjislativ për lirimin apo përcaktimin e tarifa për amvisëritë e caktuara.	Komuna edhe këtë vit ka të njëjtën gjendje.	Rekomandim i pazbatuar.

9	Shfrytëzimi i lokaleve afariste me çmim më të ulët	Kryetari duhet të sigurojë se personat përgjegjës respektojnë Rregulloren për dhënien në shfrytëzim të hapësirave publike përmes ankandit publik dhe kriteret e vendosura të bazohen në rregulla duke ofruar mundësin e përfitimeve maksimale nga procesi i ankandit.	Në vitin 2019 komuna nuk kishte kontraktime të reja për shfrytëzimin e lokaleve.	Rekomandim i mbyllur.
10	Pagat dhe mëditjet-Mangësi në proces rekrutimit sipas ligjit të punës	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime të menjëhershme për ta shqyrtuar këtë proces të punësimit, si dhe të sigurojë kontrolle efektive në mënyrë që proceset e rekrutimit të bëhen në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit të punës.	Për rastin e theksuar në 2018 komuna nuk ka ndërmarr aktivitete. Ndërsa në vitin aktual nuk ka gjetje në këtë fushë.	Rekomandim i mbyllur.
11	Mangësi në procedura rekrutimi për shërbimin civil	Kryetari të siguroj që emërimet e kandidat.ve bëhen vetëm pasi të jenë zbatuar të gjitha procedurat e rekrutimit dhe emërimit në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.	Nga dy rastet e testuar vlerësojmë se rekomandimi është zbatuar.	Rekomandim i zbatuar.
12	Mungesë e dosjeve të personelit dhe pagesa pa bazë ligjore	Kryetari të siguroj rishikimin e mundësisë që këta zyrtarë të transferohen në institucionet ku ata punojnë, ose të kompletohen dosjet e tyre në komunë për të krijuar bazë ligjore për ekzekutimin e pagave të tyre. Pagesat e shtesave bëhen vetëm për zyrtarët që parashihen me vendimin e Qeveris dhe shumat e përfituara në kundërshtim me këtë vendimi ti kthehen buxhetit të komunës.	Ky rekomandim do të rregullohet me ligjin e ri të pagave.	Rekomandim i mbyllur.
13	Dosjet e personelit të pa azhurnuar	Kryetari të sigurohet se drejtoret e institucioneve arsimore dhe menaxheri i personelit duhet të kompletojnë dëshmitë për përvojën e punës për të krijuar bazë ligjore për ekzekutimin e shtesës në bazë të përvojës. Po ashtu drejtoret e shkollave të monitorojë vlerësimet e performancës dhe dëshmitë e njëjta të vendosen në dosje të personelit.	Kemi gjetë se edhe këtë vit në dosjet e personelit, mungon vërtetimi mbi përvojën e punës në shëndetësi.	Rekomandim i pazbatuar.
14	Zyrtaret pa kontratë valide të punës	Kryetari i komunës duhet të siguroj se para skadimit të kontratave të punëtorëve të fillohet me procedurat e rekrutimit apo nëse paraqitet nevoja për vazhdimin e kontratave,	Nga mostrat e testuara nuk kemi vërejtur se ka zyrtar pa kontrat.	Rekomandim i zbatuar.

		procedurat e vazhdimet të jenë në përputhje me rregullat dhe udhëzimet në fuqi.		
15	Kompensimin jo i rregullt i pushimit të lehonisë	Kryetari të sigurojë që personeli kompetent përcjell me kohë ndryshimet në listën e pagave dhe ndalesat e pushimit të lehonisë behën sipas rregullave dhe aplikohen në periudhën e duhur kohore.	Nga mostrat e testuara nuk kemi vërejtur ndonjë gabim për çështjen e ndalesave të pushimit të lehonisë.	Rekomandim i zbatuar.
16	Mallra dhe shërbime-Parregullsi në angazhimin e stafit për shërbime të veçanta	Kryetari duhet të sigurojë se marrëveshjet për shërbime të veçanta të planifikohen drejt dhe angazhimet për këto shërbime të mos zgjasin më shumë se gjashtë muaj. Po ashtu kryetari duhet të sigurojë se punonjësit me kontrata për shërbime të veçanta do të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike.	Komuna prapë ka angazhuar staf me MSHV, jo në përputhje me ligjin.	Rekomandim i pazbatuar.
17	Parregullsi e shpenzime për udhëtime zyrtare	Kryetari duhet të fillojë një shqyrtim gjithëpërfshirës si dhe financimi i udhëtimeve të personave jashtë komunës të bëhet vetëm në rastet kur pjesëmarrja e personave të tillë sjell përfitime direkt për komunën dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi.	Nga rastet e testuara nuk kemi gjetur parregullsi të kësaj natyre.	Rekomandim i zbatuar.
18	Investimet Kapitale-Dobësi sistematike në menaxhimin e pagesave dhe pranimin e punëve	Kryetari duhet të forcoj masat e kontrollit që dështimet e tilla të mos përsëriten. Duhet sigurohet se për mbikëqyrjen e projekteve janë vendosur zyrtar kompetent të cilët monitorojnë implementimin e kontratës dhe pranojnë vetëm punët e realizuar, nënshkruajnë situacionet sipas gjendjes faktike, në të kundërtën duhet të aplikohen masat për lëshimet e pa përgjegjshme apo neglizhente.	Edhe këtë vit kemi gjendjen e njëjtë sa i përket mbivlerësimit të pagesave.	Rekomandim i pazbatuar.
19	Prokurimet pa zotim të mjaftueshëm, zotimi pas pranimit të faturave/pranimi të mallit dhe mungesa e projekteve ekzekutiv	Kryetari të sigurojë që kontrollet janë funksionale dhe zyra e prokurimit nuk duhet të nënshkruaj asnjë kontratë publike pa zotim të mjeteve apo ndërmerr obligim në një shumë që i tejkalon fondet e ndara. Gjithashtu, duhet të sigurojë që hartimi i projekteve ekzekutive të realizohet në pajtim me kërkesat ligjore para inicimit të procedurave të prokurimit për punë, në të kundërtën nuk mund	Komuna edhe këtë vit ka nënshkruar kontrata pa zotim të mjeteve, dhe në mungesë të projektit ekzekutiv.	Rekomandim i pazbatuar.

		të fillon tenderimi i ekzekutimit të projekteve.		
20	Mungesa e dëshmimeve gjatë vlerësimit të kriterëve për dhënien e shtëpive për familjet skamnore	Kryetari i Komunës të siguroj kontrolle të shtuara që gjatë vlerësimit të aplikacioneve për programet e veçanta të banimit, procesi i poentimit të kriterëve të vendosura duhet të mbështetet me dëshmi përkatëse.	Komuna ka arritur të siguroj dëshmitë adekuate për kriteret e përcaktuara, në rastet që janë audituara.	Rekomandim i zbatuar.
21	Mos vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit krahas periudhës së zbatimit të kontratës.	Kryetari të zhvillojë politika dhe procedura për t'u siguruar që realizimi i projekteve përbushët brenda kornizës kohore të përcaktuar në kontratën përkatëse dhe të garantohen me siguri të ekzekutimit gjatë tërë periudhës të përfundimit të punimeve në bazë të marrëveshjes kontraktuale, duke eliminuar edhe mundësin e kontraktimit pa fonde të mjaftueshme si dhe pengesat tjera gjatë ekzekutimit të punimeve.	Edhe këtë vit nuk ka vazhdim të sigurimit të ekzekutimit krahas periudhës së zbatimit të kontratës.	Rekomandim i pazbatuar.
22	Vonesat në ekzekutimin e kontratave	Kryetari të sigurojë kontrolle më të fuqishme në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve në mënyrë që ato të përfundohen sipas planit dinamik dhe pengesat si mungesa e mjeteve dhe problemet pronësorë janë eliminuar para hyrjes në kontratë. Aty ku vonesat janë rezultat i kontraktuesit të zbatohen masat ndëshkuese sipas kushteve të përcaktuara në kontratë, në mënyrë që të rritet përgjegjësia tek operatorët ekonomik.	Edhe këtë vit kemi konstatuar se kishte vonesa në ekzekutimin e kontratave.	Rekomandim i pazbatuar.
23	Pagesat e gjobave si pasojë e vonesave në kryerjen e obligimeve	Kryetari i Komunës duhet të rrisë kontrollet në menaxhimin e projekteve. Fillimisht duhet të sigurohen fondet e nevojshme si dhe të gjitha parakushtet tjera për fillimin e projekteve, e më pas të zhvillohen procedurat tjera për kontraktimin me OE. Me tutje, të sigurojë kontrolle në monitorimin e pagesave të faturave në afatin ligjor deri në procesin e ekzekutimit të pagesave.	Menaxhmenti nuk ka arritur të krijoj një mekanizëm konkret në parandalimin e këtyre pagesave.	Rekomandim i pazbatuar.

24	Mos komunikimi dhe informimi me rastin e pagesave nga Thesari	Kryetari të siguroj që marrëveshjet e nënshkruara me donatorë dhe operator të zbatohet në tërësi dhe të mos këtë vonesa në kryerjen e obligimeve kontraktuale. Të vendosen kontrole që parandalojnë gabimet e tilla dhe të sigurohet se për çdo gabim/lëshim nga organizatat varëse komuna e identifikon dhe reagon me kohë. Gjithashtu, të ndërmerren masa për vendosjen e komunikim me thesarin dhe informimin me kohë për pagesat që ekzekutohen nga thesari.	Janë ndërmarr veprime për rastin konkret, mirëpo ka ende raste ku thesari bënë pagesa pa komunikuar me komunën.	Rekomandim i pazbatuar.
25	Pasuritë-Mangësi në inventarizimin dhe evidentimin e pasurisë dhe mungesë e procedurës së brendshme	Kryetari duhet të sigurojë se procesi gjithë përfshirës i regjistrimit të pasurive duhet të përfundoj me kohë dhe vazhdoj me vlerësimin e pasurisë brenda një afati optimal dhe pas përfundimit të procesit të përgatit një raport përfundimtar mbi gjendjen e pasurive, të cilin duhet ta harmonizoj me regjistrat kontabël të komunës. Diferencat e shfaqura duhet të sqarohen dhe regjistrat duhet të azhurnohen sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit. Kërkesat në lidhje me regjistrimin dhe mirëmbajtjen e pasurive duhet të aplikohen në tërësi, përmes sistemit E-pasuria të evidentohen të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme (me vlera nën 1,000€) për të gjitha dikasteret komunale. Gjithashtu, duhet të siguroj hartimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare sipas kërkesës së rregullores 02/2013.	Komuna ka përgatitur rregulloren e brendshme për menaxhimin e pasurive, mirëpo ende ka mangësi sa i përket inventarizimit, vlerësimit dhe evidentimit të pasurive.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.
26	Të arkëtushmet-Niveli i lartë i të arkëtueshmeve	Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet kontraktuale.	Komuna ka formuar një komision në lidhje me LLA, mirëpo edhe këtë vit ka nivel të lartë të LLA.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.

27	Obligimet e pa paguara- Niveli i lartë i obligimeve	Kryetari duhet të forcojë kontrollet në procesin e menaxhimit të pagesave për të siguruar që komuna mos të hyjë në obligime pa fonde të mjaftueshme, që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor. Po ashtu të sigurojë se raportimi i obligimeve bëhet për çdo muaj në përputhje me kërkesat ligjore e cila duhet të përfshijë gjendjen e saktë të tyre.	Niveli i obligimeve edhe këtë vit është i lartë.	Rekomandim i pazbatuar.
28	Mos adresimi i rekomandimeve të NJAB	Për të arritur përfitimin maksimal nga shërbimet e auditimit të brendshëm, Kryetari duhet të sigurojë se do të plotësohet me personel të mjaftueshëm NjAB, si dhe të rishikojë arsyet për veprimet e limituara të ndërmarra në lidhje me rekomandimet. Gjithashtu, duhet të ndermirën veprime shtesë për funksionalizimin e KA-të në mënyrë që të sigurojë mbikëqyrjen, ngritjen dhe fuqizimin e rolit të auditimit të brendshëm.	Edhe përkundër disa veprime të ndërmarra, një numër i rekomandimeve mbetet i pazbatuar. Personeli i NjAB nuk është plotësuar sepse nuk kishte kandidat të përgjegjshëm në konkursin e shpallur, dy herë.	Rekomandim i mbyllur.
29	Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili mund të nxirren të gjitha informatat relevante që ndikojnë në vendimmarrjen cilësore dhe me kohë të menaxhmentit. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe zbatimi i planit të prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit.	Kjo çështje nuk do të trajtohet në raportin e vitit 2019.	Rekomandim i mbyllur.
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
1	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që kërkesat të planifikohen dhe kategorizohen sipas ndarjes adekuate të buxhetit. Nëse projeksionet e buxhetuara me ligj të buxhetit nuk përkrijnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e komunës, duhet të bëhet ridestinimi i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve. Kjo duhet të reflektoj në përpjekjen për buxhetimin e kërkesave në kategoritë përkatëse ekonomike dhe fuqizimin e kontrollit për pagesën, evidentimin dhe prezantimin e drejt të shpenzimeve publike në PFV.		

2	Të hyrat	Kryetari i Komunës të siguroj marrjen e masave komunale për largimin e shfrytëzuesëve të pronave publike në mënyrë ilegale, arkëtimin e borxheve dhe më pastaj dhënia e pronës publike me qira të realizohet sipas Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale 06/L-092.
3	Të hyrat	Kryetari duhet të vendos kontrolle duke caktuar zyrtar përgjegjës që përcjelljen ndryshimin/plotësimin e rregullave/ligjeve të nivelit qendror, dhe që të njëjtat përditësimet të cilat kanë ndikim në rregulloret e brendshme komunale, duhet me kohë të iniciohen për ndryshim duke i përcjellur për miratim tek organet relevante dhe monitorohet zbatueshmëria e tyre.
4	Të hyrat	Kryetari duhet të shtoj kontrollet në mënyrë që të gjitha Lejet Ndërtimore lëshohen sipas kërkesave ligjore dhe të hyrat inkasohen në kohën e duhur.
5	Të hyrat	Kryetari i Komunës duhet të siguroj bashkëpunim dhe komunikim më të mirë në mes të Departamentit të Tatimit në Pronë Komunal dhe Ministrisë së Financave, në mënyrë që të eliminohen gabimet e mundshme në bazën për tatimin e vlerësuar, apo ndonjë gabim tjetër eventual.
6	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se do të kryhen analiza të mirëfillta nga menaxhimi i mbeturinave në mënyrë që të arrihen objektivat e komunës në krijimin e sistemit të qëndrueshëm financiar. Po ashtu, të merret në konsideratë që paraprakisht të rifreskohet data baza e ngarkesave si dhe të bëhen ndryshimet dhe aprovimet në rregullore nga organi legjislativ për lirim apo përcaktimin e tarifave për amvisëritë e caktuara.
7	Pagat dhe mëditjet	Kryetari të sigurohet se drejtorët e institucioneve shëndetësore dhe menaxheri i personelit duhet të kompletojnë dëshmitë për përvojën e punës për të krijuar bazë ligjore për ekzekutimin e shtesës në bazë të përvojës.
8	Mallrat dhe shërbimet	Kryetari duhet të sigurojë se marrëveshjet për shërbime të veçanta të planifikohen drejt dhe angazhimet për këto shërbime të mos zgjasin më shumë se afati i paraparë ligjorë. Po ashtu kryetari duhet të sigurojë se punonjësit me kontrata për shërbime të veçanta do të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike.
9	Mallrat dhe shërbimet	Kryetari i Komunës të siguroj që komisionet për pranimin e mallrave/shërbimeve të vendosura si pika të kontrollit të shqyrtojnë paraprakisht të gjithë dokumentacionin dhe sigurohen se mallrat/shërbimet janë pranuar para se të lejohen urdhër pagesat. Në të kundërtën duhet të zbatohen masat për lëshimet e identifikuar dhe papërgjegjësinë e komisioneve.
10	Mallrat dhe shërbimet	Kryetari i komunës të siguroj që janë vlerësuar nevojat e tërësishme të komunës për furnizime, shërbime të ngjashme dhe të lidh kontratë të përbashkët me qëllim të kontraktimit me çmime më të favorshëm për komunën dhe sigurimin e cilësisë më të lartë të furnizimit.
11	Mallrat dhe shërbimet	Kryetari të siguroj që menaxheri i prokurimit nuk nënshkruan kontrata pa siguruar se janë plotësuar dhe kushtet e pranueshmërisë së tenderëve.
12	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të siguroj që ka transparencë në procedura dhe vendimmarrje në gjithë ciklin e ofrimit të mbështetjes financiare, duke përfshirë publikimin e kriterëve dhe procedurave, aplikimin, vendimmarrjen dhe përzgjedhjen e përfituesve. Çdo ofrues i mbështetjes financiare (komuna) që planifikon mbështetje financiare për OJQ-të duhet të disponojnë me kapacitete institucionale, duke përfshirë burimet e nevojshme njerëzore për të zbatuar kërkesat ligjore. Komisioni Vlerësues të përbëhet nga anëtarë që kanë përvojë dhe integritet, me mandat për

		shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve, në të kundërtën duhet të zbatohet parimi i llogaridhënies për shfrytëzimin e këtyre fondeve.
13	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që hartimi i projekteve ekzekutive të realizohet në pajtim me kërkesat ligjore, gjegjësisht hartimin e tyre para inicimit të procedurave të prokurimit.
14	Investimet kapitale	Kryetari i Komunës të siguroj kontrolle të shtuara që para nënshkrimit të kontratave të bëhet zotimi i mjeteve në mënyrë që të eliminohet praktika e pranimit të mallit dhe punëve pa zotim të mjeteve.
15	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj përmes zyrtarëve përgjegjës, që çdo projekt të realizohet brenda kornizës kohore të përcaktuar në kontratat dhe se sigurimi i ekzekutimit duhet të ketë vlefshmëri në raport me periudhën e përmbushjes së kontratës ashtu siç parashihet në ligj.
16	Investimet kapitale	Kryetari përmes menaxherëve të kontratave duhet të sigurohet që fillimisht të mos lejoj ndryshime-tejkalime të pozicioneve të paramasave të kontraktuara, dhe nëse paraqitet nevoja për ndryshime të raportohet për çdo devijim nga termat dhe kushtet e kontratës. Po ashtu, çdo ndryshim në kushtet e kontratës duhet të arsyetohet në detaje nga menaxheri i projektit, përgatitet nga prokurimi dhe aprovohet nga nivelet relevante.
17	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që paraprakisht të eliminohen kontestet pronësore, të sigurohen fondet e nevojshme, planifikim i mirëfilltë si dhe të forcohen kontrollet në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve në mënyrë që ato të përfundohen me kohë sipas planit dinamik. Aty ku është e nevojshme të zbatohen masat ndëshkuese sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.
18	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë që për të gjitha shpenzimet paraprakisht personat përgjegjës ushtrojnë kontrollet adekuate, në mënyrë që të bëjnë barazimet e nevojshme para realizimit të pagesave.
19	Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Kryetari duhet të siguroj që kërkesat në lidhje me regjistrimin dhe mirëmbajtjen e pasurive duhet të aplikohen në tërësi, ku përmes sistemit e-pasuria evidentohen të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme (me vlera nën 1,000€) për të gjitha dikasteret komunale. Po ashtu, duhet të siguroj që raportet e komisionit të inventarizimit dhe ai i vlerësimit të finalizuar, harmonizohen me gjendjen e pasurisë në regjistra dhe i paraprijnë përgatitjes së PFV, në mënyrë që vlera e pasurisë të prezantohet saktë.
20	Të arkëtueshmet	Kryetari duhet të siguroje që llogarit e arkëtueshme të shpalosura në PFV të harmonizohen me raportet financiare mbi tatimin në pronë të verifikuar paraprakisht për plotësin dhe saktësinë e tyre. Të shqyrtoj në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.
21	Detyrimet e papaguara	Kryetari duhet të forcojë kontrollet në procesin e menaxhimit të pagesave për të siguruar që komuna mos të hyjë në obligime pa fonde të mjaftueshme, dhe që të gjitha faturat paguhën brenda afatit ligjor.
22	Detyrimet e papaguara	Kryetari të siguroj që prezantohen saktë në shpalosje vetëm obligimet të cilat kanë raport të përfundimit të punëve/shërbimeve apo furnizimeve para lëshimit të faturës, duke siguruar që të prezantohen drejtë ato.
23	Detyrimet kontigjente	Kryetari duhet të siguroj që detyrimet kontigjente janë prezantuar drejt në PFV. Duhet të sigurohen të dhënat e sakta dhe të plota mbi këto detyrime nga zyra ligjore dhe të njëjtat të përcillen në zyrën e financave si hartues të PFV.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së **Prizrenit**, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Mytaher Haskuka

Kryetar i Komunës së Prizrenit

Data: 30.07.2020, Kosovë

